

Republika e Shqiperise  
Gjykata Administrative e Shkalles se Pare  
Korçe

**KORÇE**

Nr 314 rregjistri themeltar.  
Date rregjistrimi 13.02.2015

Nr 203 Vendimi  
Date 21.04.2015.

**V E N D I M**  
**“Ne emer te Republikes”**

Gjykata Administrative e shkalles se pare Korçe e perbere prej:

Kryetare e seances gjyqesore - **ETLEVA GJAMO**

asistuar nga sekretare e seances gjyqesore Viola Palla , ne Gjykate, ne date 21.04.2015 , ora 13 30 mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore me dyer te hapura çeshtjen administrative me nr 314 rregjistri themeltar , date 13.02.2015 rregjistrimi qe i perket:

**PADITES:** Shoqeria “DAISY &ETM” Shoqeri e thjeshte , me seli ne Korçe, me adrese rruga “Marigo Pozio”, me perfaqesues ligjor Engjellushe Frasherit, e perfaqesuar ne gjykim nga av Ermir Petruti i Dhomes se Avokatise Tirane, ne mungese.

**E PADITUR:** Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçe, perfaqesuar me autorizim nga juristja Mirela Veriga.

**OBJEKTI:** Shfuqizim teresisht i aktit administrativ “Njoftim vleresimi per detyrimet tatimore”, nr 16 616 Prot date 10.09.2014 te DRT Korçe, si nje akt administrativ relativisht i paylefshem dhe anulimin e gjobes ne vleren 100 000 leke.

**Baza ligjore:** Neni 44 i Kushtetutes, neni 109/1, 123 i Ligjit nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore ne Republikën e Shqiperise” i ndryshuar, Udhezimi nr.24 date 02.09.2008, VKM nr 781 date 14.11.2007 nenet 7/a, 11/1, 15/a, 16/1 dhe 17, pika 1/a e ligjit 49/2012, neni 115/b dhe 118 i Kodit te Procedurave Administrative.

Ne perfundim te gjykimit te zhvilluar ne mungese te perfaqesuesit me autorizim te pales paditese, megjithese ka dijeni dhe ne prani te perfaqesueses me autorizim te pales se paditur, perfaqesuesi i paditesit ne pretendimet perfundimtare te depozituara me shkrim ka kerkuar pranimin e padise, perfaqesuesja e pales se paditur kerkoj rrezimin e padise.

Gjykata pasi shqyrtoi aktet dhe çeshtren ne teresi

**V E R E N**

Nga aktet bashkangjitur padise, rezulton se shoqeria “Bashkimi i Operatoreve DAISY &ETM” -Shoqeri e thjeshte, me seli ne qytetin e Korçes, ushtron aktivitetin e



21

Ne baze te pikes 15.1 te Udhezimit nr 16 date 03.05.2010 "Per administrimin dhe dokumentimin e procedurave te pajisjeve fiskale", nderimi i memories fiskale behet nga shoqerite e autorizuar vetem pasi te jete mare konfirmimi nga strukturat e DRT.Pvaresisht faktit se subjekti Avenir Demi e ka çuar per riparim memorien fiskale prane filialit te shoqerise paditese ne Sarande, perfaqesuesi i ketij filiali i ka bere te ditur se nderimi i memorjes behej vetem pas miratimit te DRT dhe subjekti e ka mare pajisjen dhe e ka mbajtur ne ambientet e tij, provuar me aktin e konstatimit date 27.07.2014.

Lidhur me konfirmimin e DRT Sarande shoqeria ka mare dijeni ne daten 24.07.2014 dhe ishte detyrim i tatimpaguesit qe ta paraqiste serish pajisjen fiskale prane shoqerise paditese se bashku me konfirmimin e pageses per kete sherbim dhe nga ky moment paditesi kishte detyrimin ligjor per realizimin e sherbimit brenda afatit prrej 36 ore.

Prrej dates 21.07.2014 e deri ne daten 27.07.2014 kur eshte kontrolluar subjekti, ai nuk e ka çuar pajisjen prane shoqrise dhe nuk ka bere pagesen perkatshe por e ka çuar ate ne daten 30.07.2014 pra pra pas kontrollit.

Persa me siper paditesi nuk ka kryer asnje shkelje ligjore pasi ka respektuar afatin 36 ore te ofrimit te sherbimit.Strukturat e DRT Sarande duke mos kryer nje hetim objektiv dhe duke mos kontaktuar me perfaqesuesin e paditesit per sqarimin e situates , kane gabuar duke hartuar procesverbalin e gjobes dhe me tej ka gabuar edhe DRT Korçe duke legjitimuar sanksionin ndaj paditesit.Pra vullneti i organit administrativ ka qene me ves pasi provat qe i jane vene ne dispozicion kane qene te rreme pasi nuk paraqesin gjendjen faktike te situates se konstatuar dhe per kete arsye duket te shfuqizohet njoftim vleresimi si akt relativisht i pavlefshem.

**Perfaqesuesja e pales se paditur** gjate gjykimit dhe ne perfundim te tij prapesoi se ne kontraten e shitjes se pajisjes fiskale te lidhur midis shoqerise paditese dhe subjektit Avenir Demi jane percaktuar te drejtat dhe detyrimet e paleve te cilat duhet ti referohen jo vetem Kodit Civil por edhe akteve nenligjore pasi shoqerite e autorizuar duhet te sigurojne stafin teknik per mirembajtjen e rregjistruesve elektronike.Ne piken 20.2 te VKM nr 781, date 14.11.2007, parashikohet se mriembajtja e rregjistruesve elektronike perfshire edhe mirembajtjen e memorjes fiskale, nuk duhet te zgjase me shume se dy dite nga data e paraqitjes se ankeses per parregullsi dhe shoqeria kishte detyrimin te bente mirembajtjen e kases brenda 36 oreve nga momenti i raportimit te defektit.

Ne daten 17.07.2014 eshte mbajtur procesverbali midis shoqerise dhe subjektit nga i cili rezulton se tatimpaguesi ka njoftuar shoqerine e cila e ka mare ne dorezim kases fiskale per riparim si dhe percaktohet edhe afati 36 ore per kthimin e pajisjes nga momenti i marjes ne dorezim.Subjekti Avenir Demi ka bere kerkese prane DRT Sarande e cila i eshte pergjigjur tatimpaguesit me shkresen date 21.07.2014, pra tatimpaguesi ka plotesuar detyrimin ligjor te parashikuar ne piken 24 te VKM nr 781 date 14.11.2007 per njoftimin e Deges Tatimore dhe sherbimin e mirembajtjes se shoqerise se autorizuar.

Pretendimet e paditesit per kryerjen paraprakisht te pageses nga tatimpaguesi dhe me pas mirembajtjen e kases fiskale nga shoqeria jane te pabazuara ne ligj pasi shoqeria me mosveprim ka shkelur ligjin dhe ka konsumuar kundravajtjen e parashikuar nga neni 123.1.ç te ligjit 9920 date 19.05.2008 dhe me te drejte eshte penalizuar me gjobe.

*Gjykata pasi shqyrtoi pretendimet e paditesit, prapesimet e pales se paditur dhe provat e sjella prrej tyre, çmon se padia e paditesit eshte e pabazuar ne ligj dhe ne prova dhe si e tille duhet te rrezohet.*

Per efekt te shqyrtimit te ligjshmerise se aktit qe kontestohet, pra ligjshmerise se denimit me gjobe, ne formen e "Njoftim vleresimit tatimor", gjykata do ti referohet te dhenave te aktit te konstatimit date 27.07.2014, motivimit te shkeljes sipas procesverbaleve te denimit me gjobe si dhe dispozitave ligjore qe pretendohet se jane cenuar nga subjekti tatimpagues(paditesi).

Po keshtu do te referohet edhe ne ligjin "Per kundravajtjet administrative" nr 10 279, date 20.05.2010, i cili zbatohet per te gjitha vendimet e organeve te administrates publike qe parashikojne denime administrative e qe krijojne pasoja juridike ne raste individuale.

Ne zbatim te nenit 80.3.c) te Udhezimit nr 24 date 02.09.2008 "Per procedurat tatimore" njihet e drejta e inspektoreve tatimore qe te kryejne verifikime ne vend, pa njoftim paraprak te cilat synojne zbulimin ne kohe te shkeljeve qe kane lidhje ...me perdorimin e pajisjeve fiskale.

Shkeljet qe kane lidhje me perdorimin e pajisjeve fiskale gjejne rregullim te shprehur ne ligjin nr 9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise" ku ne nenin 122 parashikohen kundravajtjet administrative per perdorimin e pajisjeve fiskale per leshimin e kuponave dhe biletave, ndersa ne nenin 123 parashikohen denimet per shoqerite e autorizuara dhe te paautorizuara.

Po ti referohemi "Aktit te konstatimit" date 27.07.2014 nder te tjera evidentohet fakti se subjekti "Daisy& Etm" i ka shitur subjektit Avenir Demi pajisjen fiskale me te dhenat teknike te pershkruara ne akt por pajisja fiskale eshte jo ne gjendje pune prrej dates 17.07.2014. Persa me siper eshte mara masa e denimit me gjobe per mosrespektim afatesh per mirembajtjen e pajisjes fiskale.

Pala paditese kundersizton denimin me gjobe me arsyetimin se nuk ka kryer asnje veprim ne tejkalim te afateve te vendosura ne ligj dhe ne aktet nenligjore, por eshte vete subjekti Avenir Dem i cili nuk ka permbushur detyrimet e tij ne kohe pasi pagesen per sherbimin e kerkuar e ka kryer ne daten 30.07.2014 dhe sipas paditesit njoftim vleresimi per detyrimet tatimore perfageson akt relativisht te pavlefshem.

Por gjykata vlereson se njoftim vleresimi per detyrimet tatimore ka dale ne baze te ligjit pasi eshte konstatuar kryerja e kundravajtjes administrative te parashikuar ne neni 123.1/ç te ligjit 9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise".

Procedurat dhe afatet e instalimit dhe mirembajtjes se pajisjeve fiskale gjejne rregullim te shprehur ne VKM nr 781 date 14.11.2007 "Per karakteristikat teknike dhe funksionale te pajisjeve fiskale, sistemit te integruar te kompjuterizuar per transferimet periodike, automatike te deklarimeve financiare etj" ku ne piken 13.2 qe i referohet "Çertifikimit te pajisjeve fiskale", parashikohet ne menyre te shprehur se:

*13.2 Shoqëritë e autorizuara për furnizimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe pajisjeve fiskale duhet të sigurojnë stafin teknik për mirëmbajtjen e tyre. Gjatë mirëmbajtjes, teknikët e shoqërive të autorizuara mbajnë procesverbal, në dy kopje, ku pasqyrohen të dhënat rreth tatimpaguesit, i cili ka pasur ankesa për parregullsi të pajisjeve fiskale. Procesverbalet i bashkëngjiten librit të mirëmbajtjes. Mirëmbajtja e pajisjes fiskale, përfshirë edhe mirëmbajtjen e memories fiskale, nuk duhet të zgjasë më shumë se dy ditë nga data e paraqitjes së ankesës për parregullsi.*

Y2

Ndersa siaps pikes 8.3 qe i referohet "Procedures se pajisjes fiskale"parashikohen edhe procedurave e veprimeve ne rastet e perfundimit te veprimtarise se biznesit ku nder te tjera parashikohet se :

8.3.1 Në rastin e përfundimit të veprimtarisë së biznesit, tatimpaguesi është i detyruar të njoftojë administratën tatimore dhe shërbimin e mirëmbajtjes së shoqërisë së autorizuar, brenda tri ditëve nga dita e përfundimit të kësaj veprimtarie. Tekniku i autorizuar kryen procedurën e çregjistrimit me pajisje të hapur. ....

8.3.2 Shoqëria e autorizuar për shërbimin e mirëmbajtjes, kryen procedurën e regjistrimit pasi administrata tatimore ta ketë miratuar, dhe ruan memorien fiskale, sipas pikës 8.3.1 të këtij vendimi.

8.3.3 Shoqëria e autorizuar për shërbimin e mirëmbajtjes, ruan memorien fiskale, sipas pikave 8.3.1 dhe 8.3.2 të këtij vendimi, deri kur dega e tatimeve miraton, me shkrim, shkatërrimin e saj, në prani të një komisioni të përbërë nga punonjësit e shoqërisë së autorizuar të mirëmbajtjes dhe punonjësvë të degës së tatimeve.

Dispozitat e paragrafëve të kësaj pike do të zbatohen edhe për ndryshimin e memories fiskale apo të pajisjes fiskale në rast defekti.

Nga provat e shqyrtuara gjate gjykimit, rezulton se subjekti "Avenir Demi"ka paraqitur prane DRT Sarande kerkesen me shkrim per ndryshim te memorjes fiskale, per shkak te demtimit te sa, protokolluar ne daten 21.07.2014 dhe ne daten 17.07.2014 , ora 22 45 min eshte mbajtur procesverbali mes perfaqesuesit te shoqerise dhe subjektit per te dokumentuar dorezimin e pajisjes fiskale.Nga ana tjeter DRT Sarande me shkresen nr 7295/1 prot date 21.07.2014 ka lejuar shoqerine te zbateje proceduren e ndryshimit te memorjes fiskale, duke njoftuar shoqerine dhe tatimpaguesin njekoheisht.

Po ti referohemi procesverbalit date 17.07.2014 evidentohet qarte detyrimi i shoqerise per respektimin e afatit prrej 36 ore per riparimin e pajisjes dhe njoftimin subjektit per terheqjen e kases, afat i cili fillon nga nenshkrimi i procesverbalit.

Nderkohe eshte fakt se shoqeria nuk ka vepruar brenda ketij afati ligjor pasi kontrolli nga Drejtoria e Hetimit tatimor eshte kryer ne daten 27.07.2014 ku eshte konstatuar se pajisja e subjektit nuk ka qene ne gjendje pune prrej dates 17.07.2014.

Mosveprimi i shoqerise brenda afatit prrej 36 ore, perben kundravajtje administrative ne fushen e mirembajtjes se pajisjeve fiskale te parashikuar nga neni 123.1.ç i ligjit 89920 date 19.05.2008 sipas te cilit parashikohet se :

*1. Shoqerite e autorizuar qe tregetojne dhe /ose mirembajne pajisje fiskale denohen me gjobe 50 000 leke -100 000 leke nese:*

*ç) nuk ndjekin procedurat dhe nuk respektojne afatet e percaktuara ne aktet nenligjore ne lidhje me instalimin dhe mirembjatjen e pajisjeve fiskale.*

Sipas ligjit "Per kundravajtjet administrative" neni 13, germa b) kemi te bejme me mbajtje te nje procesverbali ne rastet kur konstatimi i shkeljes lidhet me vendin ku ndodh ngjarja( pra ku kryhet veprimi ne shkelje te ligjit) dhe procesverbali i konstatimit eshte akti mbi bazen e te cilit gjykohet nese eshte kryer ose jo kundravajtje administrative tatimore.

Referuar sa me siper, ne kushtet kur provohet shkelja konkrete e dispozites ligjore te cituar ne procesverbalin e denimit me gjobe, konkludohet per kundravajtje administrative dhe rrjedhimisht me te drejte eshte venbdosur dhe penalizimi i subjektit.

Sipas nenit 4 te ligjit "Per kundravjtet administrative", qe te linde baza e pergjegjesise administrative te nje subjekti duhet qe nga ana e tij te jete kryer shkelje me faj e dispozitave ligjore ose nenligjore, e kryer me veprim ose mosveprim dhe per te cilen ligji te parashikojte denim administrativ.Referuar elementeve te kesaj dispozite, çmohet se ato motivohen ne aktet e pales se paditur ne rastin objekt gjykimi, prandaj edhe penalizimi me gjobe ne shumen 100 000 leke vleresohet ne perputhje te plote me ligjin, bazuar ne gjendjen faktike te konstatuar ,provuar me prova shkresore dhe nuk permban asnje ves te vullnetit te organit administrativ dhe asnje element tjetër qe do ta bente njoftim vleresimin per detyrimet tatimore nje akt relativisht te pavlefshem ne kuptim te nenit 118 te Kodit te Procedurave Adminsitrative.

Kjo per faktin se ne momentin e nxjerrjes se ketij akti, kane ekzistuar pikerisht rrethanat qe vete dispozitat ligjore te ligjit "Per procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" kerkojne si kusht per aplikimin e denimit me gjobe, prandaj dhe padia e paditesit duhet te rrezohet si e pabazuar ne prova dhe ne ligj.

Ne veshtrim te nenit 45 germa a) te ligjit 49/2012 ky vendim eshte i paankimueshem pasi sipas kesaj dispozite.... *nuk lejohet ankim ndaj vendimeve perfundimtare te gjykates administrative per padi me objekt kundershhtimin e denimit per kryerjen e kundravajtjeve administrative me vlere me te vogel se 20-fishi i pages minimale ne shkalle vendi.*Ne baze te VKM nr. 573, datë 3.7.2013, "Per percaktimin e pages minimale ne shkalle vendi", duke filluar nga muaji Korrik 2013 e ne vazhdim, paga bazë minimale mujore, për punonjësit në shkallë vendi, eshte 22.000 ( njezet e dy mije ) leke.

Persa i takon shpenzimeve gjyqesore te takses mbi aktet ne shumen 3 000 leke dhe ato te perfaqesimit me avokat ne shumen 45 000 leke te parapaguara nga paditesi, konform nenit 106/1 te K.Pr.C mbeten ne ngarkim te tij meqenese çmohet rrezimi i padise.

### PER KETO ARESYE

Bazuar ne nenet 41-42, 45/b te ligjit 49/2012

### V E N D O S A

1.Rezimin e padise se paditesit "DAISY &ETM" SH.P.K, me seli ne Korçe, e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe , me objekt "Shfuqizim teresisht i aktit administrativ "Njoftim vleresimi per detyrimet tatimore", nr 16616 Prot date 10.09.2014 te DRT Korçe, si nje akt administrativ relativisht i pavlefshem dhe anullimin e gjobes ne vleren 100 000 leke" si te pabazuar ne prova dhe ne ligj.

2.Shpenzimet gjyqesore ne shumen 48 000 leke, te paguara nga pala paditese, mbeten ne ngarkim te saj.

3.Kunder ketij vendimi nuk lejohet ankim.

4.Nje kopje e vendimit ti dergohet per komunikim pales paditese ne mungese.

**U shpall ne Korçe date 21.04.2015**

**Sekretare  
Viola Palla**

**G J Y Q T A R E  
ETLEVA GJAMO**